

LIGJ

Nr.8303, datë 12.3.1998

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË MAQEDONASE PËR EKZEKUTIMIN E NDËRSJELLË TË VENDIMEVE GJYQËSORE
PËR ÇËSHTJET PENALE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë Maqedonase për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore për çështjet penale”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2020, datë 21.3.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARREVESHJE

NDERMJET

QEVERISE SHQIPTARE DHE QEVERISE MAQEDONASE PER EKZEKUTIMIN E NDERSJELLTE TE VENDIMEVE GJYQESORE PER CESHTJET PENALE

Per te intensifikuar bashkepunimin e metejshem ne fushen e dhenies se asistences per ceshtjet penale,

duke respektuar principin e drejtesise dhe te rehabilitimit shoqeror te te denuarve,

duke qene te bindur se keto qellime mund te arrihen me mire duke ekzekutuar sanksionet penale ne vendin shtetas te te cilit jane personat e denuar,

palet rane dakort te lidhin kete Marreveshje.

KAPITULLI I PARE

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

(1) Vendet pale ne Marreveshje, ne baze te kerkesave te paraqitura dhe ne perputhje me kushtet e percaktuara ne kete Marreveshje, ndermarrin te ekzekutojne vendimet gjyqesore per ceshtjet penale te dhena nga gjykata e e pales tjeter kunder nje shtetasi te vendit tjeter kontraktues ose kunder nje personi i cili ka nje vendbanim ne territorin e tij si psh:

1. te mbikqyre personin per te cilin gjykata ka dhene nje vendim efektiv te pezulluar gjate kohes se mbikqyrjes (tani e tutje do t'a quajme: mbikqyrje mbrojtese),

2. te ekzekutoje nje vendim me burgim ose masen e sigurise, qe jepet efektivisht nga gjykata e njerit prej vendeve-paleve kontraktuese (tani e tutje do t'a quajme ekzekutim).

(2) Nje person, i cili ne perputhje me ligjet e vendit ka shtetesine e ketij vendi, trajtohet nga pala tjeter per efekt te kesaj Marreveshje sikur te ishte shtetas i tij.

Neni 2

(1) Ekzekutimi i vendimit dhe mbikqyrja mbrojtese ne zbatim te paragrafit 1, te nenit 1 te kesaj Marreveshjeje, ne perputhje me dispozitat e saj, behet nese permbushen kushtet e meposhteme:

1. personi i denuar eshte shtetas. i vendit qe ndermerr ekzekutimin ose ai/ajo ka nje vendqendrim ne te,

2. vendimi i gjykates eshte i formes se prere dhe i ekzekutueshem,

3. personi i denuar jep pelqimin,

4. vepra per te cilen jepet vendimi konsiderohet si veper penale nga ligjet e te dy vendeve,

5. vendi qe ka dhene vendimin penal dhe vendi qe ka ndermarre mbikqyrjen mbrojtese ose ekzekutimin bien dakort te transferojne mbikqyrjen ose ekzekutimin,

6. denimi penal ose koha e mbikqyrjes mbrojtese ndaj personit duhet te jete me shume se 6 muaj, duke filluar qe nga data e paraqitjes se kerkeses.

(2) Me perjashtime vendet pale kontraktuese mund te bien dakort te transferojne mbikqyrjen mbrojtese ose ekzekutimin per nje ceshtje nese sanksioni penal ose koha per kontrollin e sanksionit penal te pezulluar te cilin duhet t'a vuaje personi i denuar, eshte me e shkurter se ajo qe citohet ne dispoziten e paragrafit 2, pika 6 e ketij neni.

(3) Ne se personi i denuar nuk eshte ne gjendje te jape pelqimin e tij per transferimin e mbikqyrjes mbrojtese ose te ekzekutimit, atehere eshte e nevojshme qe kjo te merret nga keshilltari (perfaqesuesi) i tij ligjor ne perputhje me ligjin e vendit ne te cilin personi ka vendbanimin e tij/saj.

Neni 3

(1) Mbikqyrja mbrojtese ose ekzekutimi nuk behet ne se :

1. mbikqyrja mbrojtese ose ekzekutimi eshte ne kundersizim me sistemin gjyqesor te vendit te adresuar,

2. gjykimi ne baze te te cilit ka dale vendimi i gjykates, sipas gjykimit te vendit te adresuar, eshte i nje natyre politike, ose ushtarake,

3. mbikqyrja mbrojtese ose ekzekutimi jane ne kundersizim me detyrimet qe vendi i adresuar ka ne kuadrin e marreveshjeve nderkombetare,

4. kunder personit te denuar eshte duke u zhvilluar nje gjykim penal ne vendin e adresuar per kundravajtje penale per te cilen kerkohet mbikqyrja mbrojtese,

5. ekzekutimit te denimit ne pajtim me njerit nga ligjet e vendeve-pale kontraktuese i ka kaluar afati,

6. personi denuar, persa i perket moshes ne kohen e kryerjes se kundravajtjes, nuk mund te ndiqej penalisht ne vendin e adresuar,

7. personi eshte i denuar ose ka marre pafajesi per te njeten veper ne vendin e adresuar,

8. vendimi i gjykates eshte dhene ne mungese te personit te denuar,

9. personi i denuar ka fituar te drejten e strehimit ne vendin e adresuar.

Neni 4

Vendi-pale kontraktuese nuk i dorezon shtetasit e tij ne vendin tjeter-pale kontraktuese per t'u zbatuar mbikqyrja ose ekzekutimi.

Neni 5

(1) Vendi i adresuar eshte i detyruar te vere ne dijeni vendin adresues ne lidhje me mbikqyrjen mbrojtese ose ekzekutimin.

(2) Ne rast refuzimi te pjesshem ose te plote per te ndermarre mbikqyrjen ose ekzekutimin, vendi i adresuar eshte i detyruar te jape arsyet per refuzimin e permbushjes se kerkeses.

Neni 6

(1) Personit te denuar mund t'i jepet amnesti/faje nga vendi qe ka nxjerre vendimin ose nga vendi qe ka ndermarre te zbatoje mbikqyrjen mrojtese ose ekzekutimin.

(2) Ne se vendi qe ka nxjerre vendimin ka bere te njeten gje, ai duhet te informoje vendin qe ka ndermarre mbikqyrjen mbrojtese dmth ekzekutimin.

Neni 7

Vendi, data dhe menyra e dorezimit dhe ndermarrjes se personit te denuar caktohet me marreveshje ndermjet organeve kompetente te dy vendeve-pale kontraktuese.

KAPITULLI I DYTE

Mbikqyrja mbrojtese

Neni 8

(1) Vendet-pale ne marreveshje mbi bazen e nje kerkese dhe ne perputhje me kushtet e percaktuara ne kete Marreveshje, ndermarrin gjate kontrollit mbikqyrje reciproke mbi

personin, tek i cili gjykata e njerit prej vendeve-pale kontraktuese ka dhene vendimin e pezulluar.

(2) Mbikqyrja mbrojtese ndermerret ne ate vend, shtetas i te cilit eshte personi i denuar ose ne ate vend ku personi i denuar ka vendbanimin.

Neni 9

(1) Mbikqyrja mbrojtese behet vetem ne perputhje me ligjin e vendit qe e ka ndermarre ate.

(2) Masat e mbikqyrjes qe merren nga vendi qe ndermerr mbikqyrjen, ne perputhje me llojin dhe kohezgjatjen, nuk mund te jene me te ashpra se sa ne vendin ku eshte dhene vendimi.

(3) Gjate percaktimit te masave per mbikqyrjen mbrojtese ne vendin qe ndermerr mbikqyrjen merren parasysh masat e marra ne vendin ku eshte dhene vendimi.

Neni 10

Vendi qe ka dhene vendimin ka te drejte per te anuluar vendimin e pezulluar ne çdo kohe me vendim te organit kompetent.

Neni 11

(1) Vendi i adresuar eshte e detyruar te njoftoje vendin dergues ne se kerkesa per te ndermarre mbikqyrjen mbrojtese eshte marre parasysh ne perputhje me nenin 8 te kesaj Marreveshjeje.

(2) Vendi qe ekzekuton mbikqyrjen mbrojtese informon vendin ne te cilin eshte dhene vendimi per masat e mbikqyrjes ruajtese dhe te gjitha rrethanat e tjera qe mund te shkaktojne terheqjen e denimit te pezulluar.

Neni 12

(1) Vendi i cili a dhene vendimin eshte i detyruar te informoje pa vonese vendin qe kryen mbikqyrjen per faljen ose dhenien e amnestise apo revokimin e denimit te dhene.

(2) Vendi qe jep vendimin anulon vendimin e pezulluar dhe mund t'i kerkoje vendit qe ne baze te kesaj Marreveshjeje kryen mbikqyrjen te ndermarre ekzekutimin e denimit penal sipas kesaj Marreveshjeje.

Neni 13

(1) Ne se mbikqyrja mbrojtese ndermerret nga vendi ku eshte dhene vendimi, ndalohen perkohesisht te gjitha masat e tjera qe kane te bejne me ekzekutimin.

(2) E drejta e vendit ku eshte dhene vendimi ne lidhje me ekzekutimin e vendimit mbaron ne se gjate periudhes se kontrollit nuk ndodh ndonje ndryshim i cili do te perbente arsye ne pajtim me ligjin e tij qe denimi i pezulluar te revokohet.

KAPITULI I TRETE

Ekzekutimi

Neni 14

(1) Ne se nje person, qytetar i njerit prej paleve ose qe ka vendbanimin e tij ne kete vend denohet me burgim ne vendin tjeter pate apo ne se i jepet nje mase sigurie, mund te kerkohet qe denimi me burgim ose masa e sigurise te ekzekutohet ne vendin ku personi i denuar eshte qytetar apo ku ai ka vendqendrimin e tij te perhershem

(2) Kjo Marreveshje nuk e perjashton te drejten e personit te denuar, te perfaqesuesit te tij ligjor, bashkeshortit, te afermit te grades se pare, velait ose motres te paraqese kerkese per transferimin e ekzekutimit ne gjykaten qe ka dhene vendimin ose tek vendi qytetar i te cilit eshte personi i denuar por transferimi do te realizohet ne perputhje me rregullat e kesaj Marreveshjeje.

(3) gani kompetent i vendit ku eshte dhene vendimi e njofton personin e denuar per mundesine e vuajtje s se denimitme burgim ose ekzekutimin e mases se sigurise ne vendin ku personi eshte shtetas apo ne territorin e te cilit ai ka vendqendrimin e tij te perhershem.

Neni 15

(1) Me ndermarrjen e ekzekutimit, gjykata e vendit qe e ndermerr ate percakton nje denim me burgim ose mase sigurie qe duhet te permbushet ne perputhje me ligjin duke marre parasysh edhe denimet penale te dhena nga vendi qe ka dhene vendimin.

(2) Per shkak te ekzekutimit ne vendin tjeter,-pale ne Marreveshje, personi i denuar nuk duhet te jete ne nje suate me te keqe se ajo ne te cilen ai duhet te jete ne vendin ku eshte dhene vendimi.

(3) Periudha e kohes qe kalohet ne burg ne vendin ku eshte dhene vendimi perfshihet ne denimin me burgim ose ne masen e sigurise ne vendin ku ndermerret ekzekutimi.

Neni 16

Ekzekutimi ndermerret ekskluzivisht ne perputhje me ligjet e vendit qe merr persiper ekzekutimin.

Neni 17

(1) Ne rastin e ndermarrjes se ekzekutimit vendimi cili ndermerr ekzekutimin pranon faktet e percaktuara mbi te cilat bazohet vendimi ku ai eshte dhene.

(2) Kur me kerkese merret vendimi per perseritjen e procesit penal, vendi ku jepet vendimi eshte ekskluzivisht kompetent.

(3) Ne se vendimi mbi te cilin bazohet kerkesa e paraqitur per ekzekutim, revokohet me vone ose ndryshohet ne vendin ku ai eshte dhene, ai informon menjehere vendin qe ka ndermarre ekzekutimin. mbi bazen e nje vendimi te ri gjykate, vendi qe ka ndermarre ekzekutimin vendos per vuajtjen e metejshme te denimit me burgim ose te te mases se sigurise.

Neni 18

(1) Ne se vendimi u referohet disa veprave penale ekzekutimi mund te transferohet vetem per nje pjese te samksionit penal qe ka te beje me disa prej atyre veprave penale dhe ne ate rast vebdi ku eshte dhene vendimi percakton pjesen e sanksionit penal per keto vepra. Vendi i cili ka ndermarre ekzekutimin ka te drejten t'i caktoje vendit ku eshte shpallur vendimi nje kusht per marrjen e vendimit.

(2) Ne se vendi qe jep vendimin nuk e respekton kushtin e permendur ne paragrafin e mesiperm, vendi qe ka ndermarre ekzekutimin e merr vendimin ne perputhje me ligjin e tij dhe percakton pjesen e sanksionit penal qe duhet te ekzekutohet.

Neni 19

(1) Ne se ekzekutimi ka fiuar ai nderpritet ne vendin ku vendimi eshte dhene per shkak te ekzekutimit te ardhshem. Ne se i denuari gjendet ne burg ne vendin ku eshte dhene vendimi, burgimi mund te vazhdoje derisa te behet dorezimi i tij ne vendin qe ndermerr ekzekutimin.

(2) Ne rast se i denuari nuk deshiron te vuaje denimin ne vendin qe ndermerr ekzekutimin e vendimit, vendi ne te ciin eshte dhene vendimi ruan te drejten e ekzekutimit te pjeses se mbetur te denimit. Vendi qe ka ndermarre ekzekutimin e vendimit njofton menjehere per rrethanat e reja vendin ne te cilin denimi eshte dhene.

(3) E drejta e vendit ku eshte dhene vendimi per ekzekutimin perfundon, kur i denuari ka vuajtur denimin me burgim ose masen e sigurise ne vendin qe ka ndermarre ekzekutimin ose kur personi eshte faur ose i eshte dhene amnistia.

Neni 20

(1) Nje person i denuar nuk mund te paditet, denohet apo t'i kufizohet e drejta ne ndonje menyre per nje veper penae te kryar para transferimit te ekzekutimit pa peqimin e vendit ku

eshte dhene vendimi, dhe nuk mund te dorezohet tek nje vend i trete i cilli ka paditur ose ndermarre denime penale kunder tij.

(2) Pelqimi i vendit ku eshte dhene vendimi nuk nevojitet kur:

1. i denuari nuk largohet nga territori i vendit qe ka ndermarre ekzekutimin brenda nje periudhe 45 ditore pas denimit me burgim ose perfundimit te mases se sigurise. Ne kete periudhe nuk llogaritet koha kur i denuari nuk mund te largohet nga vendi qe ka ndermare ekzekutimin pavaresisht nga vullneti i tij;

2. i denuari eshte larguar nga vendi qe ka ndermarre ekzekutimin dhe eshte kthyer perseri ne territorin e tij.

KKAPITULLI I KATERT

Dispozita te pergjithshme te procedurave

Neni 21

(1) Organet kompetente te vendeve pale ne Marreveshje komunikojne ndermjet tyre per ekzekutimin e kesaj Marreveshjeje nepermjet Ministrive te Drejtesise se te dy vendeve.

(2) Dispozitat e paragrafit 1 te ketij neni nuk perjashtojne komunikimin nepermjet rruges diplomatike.

(3) Per rastet urgjente, organet kompetente te te dy vendeve ridergojne kerkesat dhe njoftimet sipas kesaj Marreveshjeje edhe nepermjet INTERPOLIT-IT.

Neni 22

(1) Kerkesat dhe dokumentat apo aktet qe duhet te dergohen ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshjeje paraqiten me shkrim ne gjuhen e vendit kerkues te shoqeruara me perkthim te vertetuar ne gjuhen e vendit te adresuar.

(2) Nuk eshte i nevojshem legalizimi i dokumentave dhe akteve te derguara sipas paragrafit 1 te ketij neni.

Neni 23

(1) Ne se nje vend pale kontraktuese ku eshte dhene nje vendim gjykate paraqet kerkese per ekzekutimin e nje vendimi gjykimi te dhene nga nje gjykim penal, duhet t'i bashkengjiten dokumentat dhe aktet e meposhteme:

1. origjinali ose kopje e rregjistruar e vendimit gjyqesor me klauzolen sipas se ciles ai eshte i formes se prere dhe i ekzekutueshem;

2. pjese nga teksti i dispozites ligjore mbi te cilen ai eshte bazuar;

3. identiteti i personit te denuar, shtetesine e tij si edhe vendbanimin ose vendqendrimin;

4. nje vertetim ku te percaktohet kohezgjatja e denimit penal te vuajtur si edhe ndonje ndalim tjeter, lirim nga denimi dhe çdo te dhene tjeter qe ka te beje me vuajtjen e denimit dhe masen e sigurise te cilat duhen marre parasysh;

5. dekaraten zyrtare te te denuarit qe verteton pelqimin e tij per transferimin e denimit dhe mbikqyrjen mbrojtese leshuar para gjykates se vendit prej ku transferohet;

6. dokumenta te tjera dhe te dhena qe mund te jene te rendesishme ne marrjen e vendimit ne gjykim.

(2) Ne se vendi shtetas i te cilit eshte i denuari paraqet kerkese per ekzekutimin e nje vendimi gjyqesor ne nje gjykim penal, duhet te bashkengjiten:

1. te dhena personae te te denuarit, te dhena per shtetesine e tij dhe vendbanimin, ose vendqendrimin i tij;

2. ne se personi i denuar eshte akoma ne vend, dekarata zyrtare e vendit per dhenien e pelqimit per transferimin e ekzekutimit dhe mbikqyrjes mbrojtese;

3. shkresat dhe te dhenat e tjera qe mund te jene te rendesishme per vendimarrjen ne gjykim.

(3) Ne rastin e paragrafit 2 te ketij neni, vendi qe ka dhene vendimin e gjykates, bashkengjitur me dekaraten zyrtare qe poteson kerkesen, paraqet nje kopje te rregjistruar te vendimit te gjykates me nje klauzole te qenies ne fuqi, nje pjese nga dispozita mbi te cilen eshte vendosur vendimi dhe nje vertetim ne perputhje me piken 4, paragrafi 1 te ketij neni.

Neni 24

(1) Ne se vendi prites eshte i mendimit se shkresat dhe te dhenat e derguara jane te pamjaftueshme, ai kerkon te dhenat shtese duke caktuar nje afat te arsyeshem i cili mund te zgjatet me kerkese te shtetit dergues.

(2) Nese kerkesa per shtesat brenda afatit te caktuar nuk permbushet, vendimi i gjykates per kerkesen e transferimit te ekzekutimit merret mbi bazen e te dhenave te disponueshme.

Neni 25

Nese personi i denuar ndodhet ne vendin qe ka dhene vendimin, per shkak se ekzekutimi ose mbikqyrja mbrojtese e miratuar duhet te transferohen ne vendin qe ka ndermarre ekzekutimin ose mbikqyrjen mbrojtese, zbatohen dispozitat e Marreveshjes mbi Ekstradimin lidhur mes dy vendeve.

Neni 26

Vendi, data dhe menyra e dorezimit dhe e pranimit do te percaktohen ne nje marreveshje ndermjet organeve kompetente te vendeve-pale kontraktuese.

Neni 27

Ne pajtim me dispozitat e neneve 26, 27 dhe 28 te Marreveshjes secili vend ne marreveshje me kerkese te pales, lejon transportimin ne territorin e tij te personit te denuar, te cilin e dorezon nje pale e trete tek nje vend i paleve ne marreveshje qe i ka kerkuar te beje transportin.

Neni 28

(1) Shpenzimet qe rrjedhin nga dorezimi i te denuarit ose si pasoje e mbikqyrjes mbrojtese apo ekzekutimit, sipas kesaj marreveshjeje paguhen nga vendi qe ka ndermarre mbikqyrjen mbrojtese apo ekzekutimin, pervec shpenzimeve qe lindin ne territorin e vendit ku eshte dhene vendimi.

(2) Shpenzimet e kerkuara per transportimin ajror te kerkuar te personit te denuar perballohen nga vendi kerkues.

Neni 29

Vendi qe ka ndermarre mbikqyrjen mbrojtese apo ekzekutimin eshte i detyruar t'i paraqese vendit ku eshte dhene vendimi, informacionin per vuajtjen e sanksionit penal, si :

1. per mbikqyrjen mbrojtese te ekzekutuar ose ekzekutimin;
2. ne se i denuari eshte arratisur nga burgu para se te ekzekutohej sanksioni penal;
3. ne se vendi qe ka dhene vendimin kerkon nje raport te vecante per te.

Neni 30

(1) Ne perputhje me kete Marreveshje "gjuha e vendit kerkues" eshte:

1. Per Shqiperine: gjuha shqipe;
2. Per Maqedonine: gjuha maqedonase.

(2) Ne perputhje me kete marreveshje "sanksion penal" do te thote cdo denim ose mase sigurimi qe permban vendimi gjyqesor ne perputhje me ligjin e vendit ku eshte dhene vendimi.

Neni 31

Kjo Marreveshje zbatohet edhe per vendimet gjyqesore te dhena para se kjo Marreveshje te hynte ne fuqi.

KAPITULLI I PESTE

Dispozita perfundimtare

Neni 32

Kjo Marreveshje nuk prek detyrimet qe rrjedhin nga marreveshjet shumepaleshe.

Neni 33

Kjo Marreveshje duhet te ratifikohet.

Ratifikimi kryhet nga secila pale ne perputhje me legjislacionin e vet.

Kjo Marreveshje hyn ne fuqi ne diten e 30-te mbas kembimit te dokumentave te ratifikimit.

Neni 34

Kjo Marreveshje perfundohet per nje periudhe te pacaktuar kohe. Secili vend-pale ne Marreveshje, mund te terhiqet nga Marreveshja pas kalimit te 6 muajve nga njoftimi me akt shkresor, dorezuar ne rruge diplomatike.

Kjo Marreveshje perfundohet ne Shkup me date 15.01. 1998 ne dy kopje origjinale, per secilen gjuhe, shqipe dhe maqedonase, qe jane njelloj te barazvlefshme.

PER QEVERINE SHQIPTARE

Thomaz Konev

PER QEVERINE MAQEDONASE

A. Ljupc